

MONITORUESI I DREJTËSISË


1 janar 2018 deri më 31 dhjetor 2018

Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) mbështet rritjen e pajtueshmërisë së sektorit të drejtësisë në Kosovë me të drejtat ndërkombëtare të gjyqimit të drejtë dhe standardet e sundimit të ligjit. Për të ndihmuar në këtë përpjekje, Misioni i OSBE-së në Kosovë rregullisht monitoron dhe raporton mbi proceset gjyqësore. Monitoruesi i Drejtësisë është publikim vjetor i vëzhgimeve të Misionit të OSBE-së në Kosovë që monitoron gjykatat e shkallës së parë në Kosovë (gjykatat themelore), të cilat janë të ndara në shtatë rajone: Ferizaj (FE); Gjakovë (GJ); Gjilan (GN); Mitrovicë (MI); Pejë (PE); Prishtinë (PR) dhe Prizren (PZ). Qëllimi i Monitoruesit të Drejtësisë është të sigurojë politikëbërësve dhe aktorëve të sektorit të drejtësisë indikatorë që nuk mund të nxirren në mënyra tjera, e që do të ndihmonin në identifikimin e boshllëqeve të pajtueshmërisë në administrimin e drejtësisë dhe përcjelljen e përpamit të arritur në mbylljen e këtyre boshllëqeve.

MONITORIMI I OSBE-SË

Departamenti Gjyqësor	Seancat	Lëndët
Departamenti i Përgjithshëm (Lëndët Penale)	700	449
Departamenti i Krimeve të Rënda	1012	381
Departamenti për të mitur	30	14
Departamenti i Përgjithshëm (Lëndët civile)	432	307
Departamenti Administrativ	1	1
Departamenti Ekonomik	2	2
Gjithsej	2177	1154

PËRQINDJA E GJYQTARËVE TË MONITORUAR*




GJYKIMI NË KOHË



Efikasiteti i Gjykatës

Në raportin e tij statistikor për gjykatat për vitin 2018, Këshilli Gjyqësor i Kosovës raportoi një numër prej 273,417 lëndëve të pazgjydhura në Gjykatat Themelore në fillim të vitit 2018. Efikasiteti i Gjykatave (i definuar si lëndët e përfunduara / lëndët e pranuar) është vlerësuar me 161.20 për qind. Kështu, për çdo 100 lëndë të reja, ishin përfunduar 161 lëndë. Në fund të periudhës raportuese 2018, numri i lëndëve të pazgjydhura ishte 211,046+

RESPEKTIMI I AFATEVE PROCEDURALE NË LËNDËT E MONITORUARA



ARSYET PËR SHTYERJE NË SEANCAT JOPRODUKTIVE




* Bazuar në listën e gjyqtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (të datës 1 tetor 2018), janë përjashtuar kundërvajtjet dhe gjyqtarët e integruar rishtazi, të cilët nuk janë monitoruar.

+ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, "Raporti Statistikor i Gjykatave 2018", gjendet në <http://www.gjyqesori-rks.org/en/kjc/report/list/1>.

Në një "seancë joproductive" nuk ka ndodhur asgjë me ndonjë vlerë apo substancë (nuk është marrë asnjë provë, nuk janë dëgjuar apo nuk është vendosur për kërkesat, nuk janë diskutuar çështjet e menaxhimit, etj.).

QASJA NË DREJTËSI

PËRDORIMI I PËRFAQËSIMIT LIGJOR NË LËNDËT E MONITORUARA (Sipas rajonit të gjykatës themelore)



Numri i avokatëve

Deri në fund të dhjetorit 2018, në Odën e Avokatëve të Kosovës ishin të regjistruar 872 avokatë, ose 48 avokatë për 100,000 banorë. Më 2018, Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë raportoi se ishte vetëm një juridiksion që kishte më pak se 48 avokatë për 100,000 banorë se sa Kosova.*


- Palët pa përfaqësim gjatë procedurave të monitoruara
- Nuk është ofruar përfaqësim i plotë për të gjitha palët gjatë procedurave të monitoruara
- Të gjitha palët kanë qenë plotësisht të përfaqësuara gjatë procedurave të monitoruara

RASTET QË KANË PASUR NEVOJË PËR PËRKTHIM

Është ofruar përkthim i dobët ose ka munguar fare (65; 29%)

Përkthimi i ofruar në mënyrë adekuate 161; 71%

PËRDORIMI I PËRFAQËSUESIT LIGJOR NË LËNDËT E MONITORUARA (SIPAS GJINISË DHE ETNISË)




- Të gjitha palët kanë qenë plotësisht të përfaqësuara gjatë procedurave të monitoruara
- Nuk është ofruar përfaqësim i plotë për të gjitha palët gjatë procedurave të monitoruara
- Palët pa përfaqësim gjatë procedurave të monitoruara

GARANCITË E PROVAVE


Regjistrimi i gjykimeve penale

Neni 315 (2) i Kodit të Procedurës Penale parasheh që "shqyrtimi gjyqësor regjistrohet në mënyrë audio ose video ose në mënyrë stenografike." Misioni në Kosovë i OSBE-së ka monitoruar 892 seanca të shqyrtimit gjyqësor në lëndët penale. 68 seanca të tilla (7.6 përqind) u regjistruan në mënyrë audio-vizuale. Transkriptet stenografike ose fjalë për fjalë u mbajtën në 45 seanca (5.0 përqind). 734 seanca (82.3 përqind) u regjistruan përmes procesverbalit përmbljedhës me shkrim. 23 seanca nuk u regjistruan, ndërsa 22 seancat e mbetura u regjistruan në mënyrë të përzier apo të paspecifikuar.

BRENGAT JANË MARR PARASYSH NË SEANCAT PËR ADMINISTRIMIN E PROVAVE (JANË VËZHGUAR 531 SEANCA)



VENDIMET E ARSYETUARA



Të drejtat dhe liritë

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka vlerësuar se ka bazë të qartë për ankesë të bazuar në të drejtat dhe liritë kushtetuese në 78 (6.8 përqind) nga 1154 lëndët të monitoruara. Për më tepër, u shprehën shqetësime lidhur me pavarësinë dhe paanshmërinë e pesë (2.4 përqind) nga 208 gjyqtarët e monitoruar.

* Numri i avokatëve nga dhjetori 2018, përditësuar sipas kërkesës për informim tek KCA; Komisioni Evropian për Efikasitetin e Sistemeve të Drejtësisë, Stidimi i CEPEJ nr. 26, "Sistemet gjyqësore evropiane - Botimi 2018 (të dhënat 2016): efikasiteti dhe cilësia e drejtësisë" në dispozicion në: <https://rm.coe.int/rapport-avec-couv-18-09-2018-en/168088e9c>. Për raportin specifik CEPEJ të Kosovës shih <https://rm.coe.int/in-depth-assessment-report-of-the-judicial-system/16807828e6>.
§ Ndonëse alternativat e paraburgimit përmenden, në shumicën e rasteve përmenden vetëm fjala alternativë, në vend të ndonjë justifikimi apo analize.